



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.09.2018, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”.

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”.

3. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Gjebrea, Evis Kushi, Andrea Marto, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Klotilda Bushka dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Klevis Balliu, Nard Ndoka, Rudina Hajdari dhe Edi Paloka.

Të ftuar:

Albana Shkurta – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Elvin Lako – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Rudina Bollano – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Rudina Meneri – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ermir Omari – Përfaqësues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Fillojmë mbledhjen e ditës së sotme, datë 19.09.2018, në rend dite kemi diskutimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë” dhe atij “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës KfW Frankfurt Am Main për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”.”

Të pranishëm kemi zonjën Albana Shkurta, zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave, zotin Lako, drejtor i Përgjithshëm, zonjën Bollano, drejtoreshë, si dhe zonjën Mëneri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si të jem rrit te rruga “Fortuzi”, unë e di se çfarë shtëpie është zonja.

(Deputeti Shameti flet pa mikrofon.)

Me sa shoh për projektligjin e dytë lidhur me fondin e investimeve sociale prezentë kemi zonjën Jazxhi dhe zotin Omari, përfaqësues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Dy specialistë kanë sjellë? Nuk kishin kohë shefat të vinin, apo kishin punë të rëndësishme?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Fillojmë me projektligjin e parë.

Ju lutem, na bëni një prezantim të shkurtër se ku shikon, çfarë ndodh me aderimin e Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës dhe pse janë të rëndësishme emërimi dhe treguesit gjeografikë për produktet shqiptare.

Fjala është për ju, zonja zëvendësministre.

Albana Shkurta – Faleminderit!

Akti i Gjenevës së marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë është një nismë relativisht e re, e marrë nga vendet, e cila shtrin dhe zgjeron llojin e mbrojtjes që u ofrohet mbajtësve të markave, por tashmë duke i shtrirë këto elemente të mbrojtjes edhe për sa i përket emërimit të origjinës dhe treguesve gjeografikë, të cilët i japin disa karakteristika unike produktit dhe u japin mundësi atyre që prodhojnë këto lloj produktesh që, automatikisht në të gjitha vendet që aderojnë në Aktin e Gjenevës, në Marrëveshjen e Lisbonës, nëpërmjet regjistrimit që kryhet në një vend, të kenë mundësinë e mbrojtjes automatike të emërimit të origjinës dhe të treguesit gjeografik, tashmë edhe në të

gjitha vendet që e kanë ratifikuar këtë marrëveshje. Ky është edhe një nga rekomandimet e Bashkimit European, pasi të gjitha vendet pjesëmarrëse e kanë konfirmuar aderimin e tyre në këtë marrëveshje. Për vendet që janë jashtë BE-së, siç jemi ne, regjistrimi i treguesve të origjinës bëhet pranë Drejtorisë së Pronësisë Industriale dhe, automatikisht, në të gjitha vendet e tjera bëhet e mundur mbrojtja e këtyre elementeve të markës nga të gjithë zotëruesit e tyre. Kjo u jep mundësinë mbajtëseve të markave, të cilët kanë bërë regjistrimin e këtyre treguesve, të mbrohen kur të tjerë mund të tentojnë të regjistrohen.

Për sa u përket eksperiencave që ne kemi deri tani, në Drejtorinë e Patentave dhe Pronësisë Industriale janë regjistruar 11 tregues gjeografikë dhe/ose emërtime origjine me prejardhje nga krahina të ndryshme të Shqipërisë. Unë po përmend disa shembuj siç janë keci i Hasit, boronica e bjeshkëve kuksiane dhe Tropojës, gështenja dhe mjalti i gështenjës së Malësisë së Madhe, produktet si jufkat dibrane, molla dibrane e të tjerë. Të tilla produkte paraqesin rëndësi të veçantë për Shqipërinë, pasi, siç e përmendem, kjo është një nga mënyrat me të cilat bizneset tona ose fermerët, që prodhojnë këto lloj produktesh, mund të jenë më konkurrues në tregjet rajonale ose globale. Janë pikërisht këto karakteristika unike që u japin këtyre produkteve këtë rëndësi, duke u krijuar atyre mundësinë që edhe t'i tregtojnë dhe t'i trajtojnë në një mënyrë më *premium* në krahasim me disa produkte të tjera, të cilat kanë mundësi që të prodhohen në mënyrë masive. Domethënë u jep mundësi atyre t'i tregtojnë dhe të kenë mundësinë e mbrojtjes së elementeve të veçanta që kanë këto produkte edhe në tregjet ndërkombëtare.

Mimi Kodheli – Zonja Zëvendësministre, ju lutem, a mund të më thoni nëse ka gjoba kur vjen fjala, sepse kjo në njëfarë mënyre është e drejta e autorit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetja ime është: në rast se ka një abuzim me këtë, për shembull, pica napolitane në çdo cep të botës, nga Kina në Amerikë ti mund të gjesh një picë napolitane të shkruar, në një kohë që nuk ka fare lidhje as me Napolin dhe as me picën. Pra, si mund të evitohen këto denominime në rastin e marrëveshjes së Lisbonës, nëse ka një kapitull që i mbron emrin e origjinës apo të drejtat e zonës nga ku del ky produkt? A ka një kapitull të tillë, a ka një aneks të tillë, apo është thjesht një marrëveshje në parim multilaterale, që iu jep të drejtën vendeve, të cilat aderojnë në këtë marrëveshje, që mund të ekspozohen me këto produkte?

Elvin Lako – Pak a shumë emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë janë koncepte dhe objekte të pronësisë industriale. Pra, kanë të njëjtën mbrojtje, siç mbrohen patentat e shpikjeve, siç mbrohen modelet e përdorimit, siç mbrohen markat kombëtare apo

ndërkombëtare, është e njëjta lloj mbrojtjeje. Nëpërmjet këtyre konventave që po ratifikojmë sot, përmirësohet mbrojtja (dhe po flasim për mbrojtje ndërkombëtare të këtyre objekteve). Siç aderojmë ne në marrëveshjen e Madridit për të mbrojtur markat kombëtare dhe ndërkombëtare, ashtu mbrohen edhe objektet e origjinës dhe treguesit gjeografike edhe jashtë vendit.

Ne vjet përmirësuam ligjin që kaloi Kuvendi “Për mbrojtjen kombëtare të emërtimeve dhe të treguesve”, sepse nuk kishte një ndarje dhe një mbrojtje që tek aplikimi, që te mënyra se si do të kishte një shpikje, pra ligji i vjetër kishte një shpikje tonën, jo sipas direktivës të BE-së. Ne përmirësuam mbrojtjen kombëtare. Tani nëpërmjet këtyre traktateve bëhet që këto të mbrohen edhe në vendet ku ato eksportohen. Përgjithësisht vendeve që kanë aderuar deri tani, janë edhe vendet me të cilët kemi marrëdhënie tregtie bilaterale.

Ka dy lloj mbrojtjesh: ose duke bërë marrëveshje me çdo shtet të caktuar, ose duke aderuar në këto traktate. Çfarë ndodh nëpërmjet aderimit?! Ndodh që futet ky emërtim apo ky tregues në regjistrin, ashtu siç është regjistri i hipotekës, siç është regjistri i objekteve në pronësinë industriale dhe këto regjistrohen. Pra, ky emërtim apo tregues fiton mbrojtje për vendin e caktuar, në të cilin paguhet një tarifë fikse. Pastaj mbrojtja lind në bazë të një kërkesë që mund të bëjnë mbajtësi i së drejtës autoriteteve kompetente të atij vendi, sepse quhet i regjistruar, pronar i kësaj të drejte në atë vend të caktuar dhe kështu përfitohet mbrojtja. Pra, kjo është mbrojtja nëpërmjet regjistrimit. Po nuk u regjistrua, nuk ka mbrojtje. Pastaj janë vepra sipas legjislacionit tonë, është vepër penale nëse ka të bëjë me falsifikim, është gjykata që zgjidh çështjet civile apo është inspektorati që bën në bazë të një kërkesë apo *ex officio* kontrollin e tregut. Pak a shumë çdo vend ka mbrojtjen e vet sipas karakteristikave të çdo vendi.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka –Faleminderit, zonja kryetare!

Unë kam vetëm një pyetje të thjeshtë. Është një gjë shumë e mirë që po aderojmë në këtë konventë, sepse mbrojmë edhe të mirat gjeografike, edhe historike të vendit. Nga relacioni që keni sjellë, shikoj se kemi 11 tregues gjeografikë ose emërtime origjine me prejardhje nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, që janë regjistruar tashmë. Më vjen mirë që e shoh nga gjithë Shqipëria, si për shembull, keci i Hasit, boronica e Bjeshkëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam përshtypjen se e kanë shkruar kastile, ngaqë jeni ju që kryesoni komisionin.

Ka edhe tregues të tjerë. Ajo që më intereson të di, pasi sigurisht kjo gjë do të garantojë një mbrojtje më të mirë jashtë edhe të treguesve gjeografikë. Në kuadrin e politikës së përgjithshme për promovimin e turizmit dhe vlerave tona lokale, po na del si problematikë edhe nga projektet e reja, grantet që qeveria shqiptare sot po u jep si mundësi fermerëve shqiptarë, ata që duan të zhvillojnë një ide për agroturizmin që të ndihmohen nëpërmjet financimeve dhe projekteve konkrete, por nuk është se i njohin ato. Pra, duhet një punë shumë më efektive që qytetarët, përfituesit, të dinë se ku përfitojnë, çfarë duhet të plotësojnë dhe cilat janë të mirat që i sjellin këto iniciativa. Ky regjistrim është një gjë shumë e mirë. Zyra përkatëse që merret me ndjekjen e procedurave dhe me marrjen në shqyrtim të kërkesave nga qytetarët, ka rolin e saj, merr kërkesën, bën procedurën, e regjistron, e pranon ose e refuzon. A keni ju rolin aktiv të parashikuar në punën tuaj, ministria, konkretisht zyra përkatëse, një strategji, një politikë për të informuar, për të shkuar tek ai që është përfituesi, që nesër të mos themi se kemi 11 të regjistruar, por kemi 1 mijë të tillë? A i dinë qytetarët këto të drejta që përfitojnë? Neve si politikanë, si deputetë kjo na intereson, që të hyjmë në një marrëveshje (pa diskutim që është një pozitive), por sa përfitojnë qytetarët tanë që mund të kenë të drejtë të marrin më shumë shërbime dhe mbrojtje prej saj?

Mimi Kodheli - Po, zoti Lako.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta merrni fjalën pasi t'jua jap unë.

Elvin Lako - Më fal, më fal!

Mimi Kodheli – Mund të flisni!

Elvin Lako – Faleminderit!

Te ligji që ndryshuam vjet, ne e bëmë këtë punë, por bëmë ligjore, dhe drejtoria jonë merret fuqimisht me promovimin. Pavarësisht kapaciteteve që kemi sot, ne po i shkojmë çdo biznesi derë më derë, duke i sqaruar se cilat janë të drejtat që fitohen nga regjistrimi, nga mbrojtja e pronës industriale. Sipas treguesve, duhet të jesh grupim, gjë që është një risi e ligjit, siç e ka gjithë Europa, gjithë bota, sepse nuk është e mundur që një person të aplikojë për një produkt që është atribut i një vendi të caktuar, benefit i një grupi të caktuar krahinor apo njerëzish. Pra, nuk mund të jetë një aplikues, por duhet të jetë një organizatë. Këtu qëndron vështirësia e aplikimit të treguesve apo emërtimeve të origjinës, sepse nuk mund të vijë si aplikim i një individi.

Duhet të bashkohen disa prodhues të një zone, për të bërë regjistrimin si emërtim apo si tregues gjeografik. Ne jemi duke u marrë me këtë. Patjetër që kjo fushë, si çdo fushë tjetër, ka nevojë për investime, ka nevojë për projekte, ka nevojë të futet si lëndë mësimore nëpër shkolla, që të njihen të drejtat jo vetëm të treguesit, por edhe të objektet, të markat, çfarë benefitesh fiton një biznes i caktuar apo një person i caktuar nga të drejtat e pronësisë industriale e intelektuale në përgjithësi.

Ne e kemi marrë seriozisht këtë punë. Meqenëse u përmendën disa shifra, dikur treguesit kanë qenë 1 e 2 gjithë jetën, këta 7 a 8 a dhjetë janë bërë dy-tre vjetët e fundit. Dikur kanë qenë rreth 500-600 marka kombëtare, ndërsa sot flasim për mbi 1200 marka kombëtare. Domethënë, ka një rritje dyfish a trefish. Patjetër, ky është atribut i zhvillimit ekonomik të vendit, por edhe i punës që lidhet me promovimin dhe mbrojtjen e këtyre objekteve.

Faleminderit!

Albana Shkurta – Gjëja që dua të shtoj është edhe fakti që ne kemi një strategji kombëtare për pronësinë intelektuale, e cila në planin e saj për vitin 2018, ka parashikuar aderimin e Shqipërisë në Aktin e Gjenevës e në Marrëveshjen e Lisbonës. Fakti që ka më tepër rëndësi të theksohet, është roli kryesor në këtë strategji kombëtare, që u është caktuar të gjitha ministrive, Drejtorisë së patentave dhe pronësisë industriale, por edhe agjencive ose përfaqësuesve të drejtorive dhe institucioneve të tjera shtetërore. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është: çfarë do të bëjmë ne, që ta vëmë në zbatim qoftë mbrojtjen që të jep regjistrimi apo gjithë këtë punë që bëhet për ndërgjegjësimin e qytetarëve e të bizneseve. Në fakt, këtë gjë Drejtoria e patentave dhe pronësisë industriale e ka bërë dhe vazhdon ta bëjë, por në disa raste kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha organet, për shembull, me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, e cila ka një rol shumë të rëndësishëm në këtë pjesë, por edhe me inspektorate apo agjenci të tjera shtetërore, të cilat kanë një rol të rëndësishëm, siç e përmendi pak më parë edhe Elvini, për sa i përket ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së edukimit në lidhje me të gjitha elementet, që kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale dhe industriale, me kurrikulat në shkolla apo universitete, si dhe me komunitetin e biznesit.

Në fakt, në planin e strategjisë kombëtare janë parashikuar një sërë eventesh, të cilat *Drejtoria e Përgjithshme e Patentave të Pronësisë Industriale* i bën në bashkëpunim me agjenci, siç është AIDA apo agjenci të tjera, për të mundësuar pikërisht shtrirjen e këtyre risive, në mënyrë që të mos mbeten në kuadrin e një aderimi apo të një ligji, por të gjejnë zbatim.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Atëherë e hedhim në votim.

Kush është dakord për projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1: “Republika e Shqipërisë aderon në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji, dhe është pjesë përbërëse e tij”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, për prezencën!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.09.2018, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Gjebrea, Evis Kushi, Andrea Marto, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Klotilda Bushka dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshja, Klevis Balliu, Nard Ndoka, Rudina Hajdari dhe Edi Paloka.

Të ftuar:

Brikena Jazxhi – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Emir Omari – Përfaqësues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Mimi Kodheli – Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”.

Fjala për ju, zonja Jazxhi.

Brikena Jazxhi – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Projektligji që kemi sjellë sot në Kuvend për shqyrtim dhe miratim, synon ndryshimin e një marrëveshjeje huaje të lidhur në fund të vitit 2010 me KfW-në, e cila akordon një kredi nga fondet e qeverisë gjermane në vlerën 20 milionë euro. Kjo kredi ka pasur si qëllim financimin e projektit “Fondi i investimeve sociale”. Projekti në thelb ka dy komponentë. Komponenti i parë është ai i rrugëve, i cili synonte rehabilitimin e 100 kilometrave rrugë dytësore dhe lokale, dhe komponenti tjetër është i ujit që parashikonte ndërtimin e 20 deri në 25 skema ujësjellësish. Aktualisht punimet e projektit kanë përfunduar, dhe pagesat respektive janë bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, për projektet. Ndryshimi i marrëveshjes konsiston në shtyrjen e afatit për disbursimin e huas, pasi ka mbetur një vlerë e vogël e huas e padisboruar. Nga kredia kanë mbetur rreth 80 mijë euro, por ajo që do të përdoret është diku te 40 mijë euro për të bërë pagesën e garancisë kundrejt konsulentit që ka supervizuar punimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm shtyrjen e afatit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deri më 30 tetor 2018, pra afati i nevojshëm për të bërë shlyerjen e pagesës. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zonja Bushko, unë mendoj se specialisti i Fondit Shqiptar të Zhvillimit mund të na thotë se ku konsiston shtrimi i 100 kilometrave rrugë.

Ermir Omari – Përshëndetje! Unë jam menaxheri i komponentit të rrugëve për projektin e financuar nga KfW dhe qeveria shqiptare. Gjithsej janë financuar rreth 7 segmente rrugore, të cilat janë në zonën e Kukësit, të Pukës dhe të Shkodrës. Aktualisht, është segmenti i rrugës nacionale Qelëz prej 12,8 kilometrash, rruga Kukës – Shishtavec, e përbërë nga dy lote rreth 18 kilometër, rruga Tamarë – Vermosh e përbërë nga dy lote rreth 30 kilometër dhe rruga nacionale Iball prej 30 kilometrash.

Dua të theksoj se brenda kredisë janë bërë rregullimet e projektit dhe ndryshe nga sa ishte parashikuar në projektin final, rruga Kukës – Shishtavec është realizuar me një gjerësi më të madhe, jo 4 metër, por 4,75 metra, në total 17 kilometra. Gjithashtu edhe rruga Tamarë – Vermosh nga 4,5 metër është realizuar 5 metër brenda të njëjtit buxhet. Po ashtu janë bërë edhe auditimet e sigurisë rrugore brenda së njëjtës vlerë, që i shton një vlerë tjetër zbatimit të projektit.

Mimi Kodheli – Ka pyetje të tjera? Nuk ka!

Ndamë kohën e mjaftueshme me kolegët specialistë të Fondit dhe të Ministrisë së Financave thjesht për një shlyerje pagese prej 80 mijë eurosh, të ndarë në 45, siç ju e përmendët, edhe për një muaj. Pavarësisht se kolegu jurist, zoti Shameti, do të më korrigjonte duke më thënë se në Kushtetutë është e shkruar që: “edhe për një qindarkë nëse flitet” dhe kjo qëndron, i qëndroj gjithashtu opinionit tim të ndryshëm nga ai, që për një muaj shtyrje, në fakt, duhet të kishte një trupë, e cila do të mund ta bënte të mundur këtë pa qenë nevoja që kjo çështje të vinte për diskutim në parlament. Megjithatë, ne jemi të disponueshëm që t’ua thjeshtësojmë jetën kolegëve, duke ua thjeshtësuar në këtë mënyrë jetën edhe qytetarëve, kështu që mendoj se është koha për ta hedhur në votim.

Kush është dakord me ndryshimin? Kundër? Abstenim?

Neni 1.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

E hedhim në votim në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Faleminderit për prezencën! Punë të mbarë!

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur!

MBYLLET MBLEDHJA